



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 18
Prishtinë, me 10. 12. 2008
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Në mbledhje morën pjesë: Shkumbin Demaliaj, Emrush Xhemajli, Naim Maloku, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu, Agim Veliu, Melihate Termkolli, Bojan Stojanovič, Zulfi Merxha dhe Gani Geci.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi:
Rrustem Mustafa, kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje ishte propozuar ky

Rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të 10. 11. 2008,**
- 3. Shqyrtimi i planit për raportin vjetor të institucioneve të sigurisë,**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës i miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së 10. 11. 2008

Procesverbali i mbledhjes së 10. 11. 2008 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i planit për raport vjetor të institucioneve të sigurisë

Kryesuesi - Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri i Kuvendit të Kosovës, në kuadër të fushëveprimit të tij i ka mbikëqyrjen dhe kontrollin parlamentar ndaj Sektorit të Sigurisë në Kosovë. Jemi në përfundim të vitit. Si komision do ta organizojmë një raportim të institucioneve të këtij sektori para Komisionit. Si kryetar i Komisionit e kam hartuar një draftplan që e kemi të paraqitur në vazhdim. Ai i përmban detajet e këtij raportimi. Pas raportimit, si komision, do ta bëjmë një raport për gjendjen dhe punën e këtij sektori, në të cilin mund të jepen rekomandime. Po e hap debatin. A ka kush ndonjë propozim për këtë plan? Këtu përfshihet lista e institucioneve që duhet të ftohen të raportojnë para Komisionit.

Gani Geci - Mendoj se duhet t'i drejtojmë kërkesë Ministrisë së Drejtësisë për situatën e burgjeve në Kosovë, sepse i kemi disa raste kur po ikin nga burgjet të burgosurit. Të shihet si qëndron gjendja e sigurisë në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Melihate Termkollli - Nuk e kam të qartë, nga aspekti formal, si duhet të bëhet ky raport para Komisionit. Qeveria harton raport vjetor për punën e vet dhe Kuvendi e shqyrton atë. Komisionet sigurisht kanë të drejtë të merren me shqyrtimin e tij.

Bojan Stojanovic - Pajtohem me të gjitha ato që u thanë deri më tash. Mendoj se Komisioni ka bërë mirë që e ka marrë nismën për këtë dëgjim, sepse është mirë t'i kemi për raportim institucionet që i ka zgjedhur Kuvendi. Si komision duhet ta bëjmë një raport vjetor për Kuvendin.

Naim Maloku – Duhet ta shohim se deri ku arrijnë kompetencat tona për këtë sektor. Pastaj mund t'ua dërgojmë kërkesën me shkrim këtyre institucioneve. Një çështje tjetër është ajo që e ngriti z. Gani Geci, pra siguria në burgjet e Kosovës. Kjo çështje është në kompetencë të këtij komisioni. Pra, ju z. Gani, mund ta ngrini këtë çështje në Komision dhe ai ta shtyjë më tej. Sa i përket organizimit të dëgjimit, mendoj se koha tash është pak e shkurtër. Tani mund t'i kërkojmë planet e tyre vjetore. Mund të organizojmë edhe dëgjime publike gjatë muajit janar ose shkurt.

Shkumbin Demaliaj - Sa i përket Agjencisë Antikorrupcion s'ka nevojë të kërkohet raport shtesë. Kjo agjenci është organ i Kuvendit dhe i raporton atij. Raporti duhet të shqyrtohet edhe nga Komisioni.

Kryetari i Komisionit - Jemi deputetë dhe kemi mundësi përherë të shtrojmë pyetje për punët që na interesojnë. Edhe me shkrim mund t'u drejtojmë kërkesë institucioneve që i mbikëqyrim.

Në përfundim të kësaj pike, kryetari i Komisionit, konstatoi se ky plan miratohet, por me ndryshimet e theksuara dhe do të procedohet më tej në kohë të përshtatshme.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit - Njoftoi se Komisioni ishte pajtuar për një projekt të OSBE-së në bashkëpunim me OJQ-në KIPRED, në të cilin ka propozuar që së bashku me Komisionin t'i bëjnë disa vizita në terren. Ky projekt nuk ka dhënë rezultate të pritura. Dështimi në Gjilan dhe pjesëmarrja shumë e ulët në Pejë dhe në Mitrovicë, japin të kuptohet se diçka nuk është në rregull. Propozoj që ky projekt të shqyrtohet edhe një herë, që të mos dalim joseriozë. Në kuadër të bashkëpunimit të Komisionit me institucionet ndërkombëtare, ju njoftoj se më 15 dhjetor do të organizohet një konferencë njëditore, në të cilën do të diskutohet mbikëqyrja parlamentare dhe publike e Sektorit të Sigurisë në Kosovë. Konferenca organizohet nga DIKAFI dhe KIPRED-i. Agjendën dhe ftesën do t'i merrni në kutitë tuaja. Si kryetar i Komisioni është paraparë ta mbaj një fjalë rasti. Po ashtu në kuadër të këtij bashkëpunimi javën e kaluar një delegacion i Komisionit ka qëndruar në Shkup në një konferencë për mbikëqyrjen parlamentare. Emrush Xhemajli dhe Naim Maloku kanë marrë pjesë. Le të urdhërojnë nëse kanë diç për të thënë.

Naim Maloku - Tha se nuk mund të shkojmë sipas agjendave të OJQ-ve. E dimë se ato qëllim kryesor e kanë të marrin fonde, por pasi i kemi hyrë kësaj pune, propozoj të vazhdojmë dhe ta përfundojmë. Sa i përket organizimit të konferencës pranoj dhe e konfirmoj pjesëmarrjen time.

Gani Geci - Tha se ky projekt nuk ka qenë mirë i organizuar. Informimi ishte i vonuar, prandaj kërkoj që edhe qytetarët të informohen me kohë.

Eqrem Kryeziu - Jemi deputetë dhe askush nga jashtë nuk mund të na e caktojë agjendën. Jo pse nuk duam të jemi pjesëmarrës në organizime të tilla, por nuk kemi kohë të mjaftueshme.

Kryetari i Komisionit - Pajtohem se duhet të përfundojë ky projekt, por duhet të jetë i organizuar më mirë. Ta përfundojmë me dy vizita në Granënicë dhe në Prizren.

Gani Geci - Desha ta ngre shqetësimin tim për situatën në burgjet e Kosovës. Ka shpesh raste kur të burgosurit po ikin nga burgjet. Më 2007 kanë ikur nga Burgu i Dubravës, dy prej tyre janë vrarë në Maqedoni. Siguria e burgjeve duhet të shqyrtohet në Kuvend. Do ta pyes edhe ministren e Drejtësisë për këtë çështje. Për mua kjo është shumë shqetësuese.

Shkumbin Demaliaj – E kemi një gjendje të vështirë, por kemi edhe njerëz të pafajshëm që po mbahen padrejtësisht në burgje. Me Ligjin për faljen, kryetari ka mundësi ta shpallë amnistinë e këtyre personave.

Kryetari i Komisionit - Duke i përmbyllur diskutimet për situatën në burgjet e Kosovës theksoi se këto janë institucione të vendit tonë dhe ne do të kujdesimi që siguria në to të jetë si kërkohet.

Zafir Berisha - Theksoi se dëshiron ta shtrojë çështjen e pjesëtarëve të Divizionit të Sigurimit të Policisë së Kosovës. Ky divizion e ka bërë një ankesë për shkak të statusit të tyre. Them se si komision duhet të merremi me këtë çështje.

Kryetari i Komisionit - Jam i njoftuar për këtë çështje. Do t'ia shkruajmë një letër Ministrisë së Punëve të Brendshme me kërkesë që ankesa e këtij divizioni të shqyrtohet. Në emër të Komisionit e caktoj deputetin Zafir Berisha të kontaktojë me Ministrinë dhe me përfaqësuesit e pjesëtarëve të këtij divizioni.

Naim Maloku - Tha se e ka marrë një kërkesë të ngjashme të Shërbimit të Zjarrfikëseve të Kosovës për pagesën e shtesës së rrezikshmërisë në punë. U vendos që kjo kërkesë t'i drejtohet për shqyrtim MPB-së.

Mbledhja përfundoi në orën 12.30

E përgatiti:
Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Rrustem Mustafa